



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

---

## **RAPORT MBI GJEOGRAFINË E KRIMIT**

BAZUAR NË TË DHËNAT SASIORE PËR VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE TË  
MEKANIZMIT PËRCJELLËS PËR VITET 2013, 2014 DHE 2015

PRILL 2016, PRISHTINË

## PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
A Objekti i raportit.....	5
B Klasifikimi dhe kategorizimi i veprave penale karakteristike.....	6

### PJESA E PARË

I Demografia e Republikës së Kosovës.....	9
II Përhapja gjeografike e kriminalitetit.....	10
III Pjesëmarrja në kriminalitet.....	15
IV Analizë krahasimore : <i>Numri i personave të dyshuar – në raport me numrin e banorëve...</i> .....	16
V Konstatime.....	17
VI Rekomandime.....	17

### PJESA E DYTË

#### KRIMINALITETI SIPAS REGJIONEVE

1 PRISHTINA.....	18
1.1 Demografia.....	18
1.2 Llojet e kriminalitetit.....	19
1.3 Pjesëmarrja në kriminalitet.....	20
1.4 Analizë krahasimore : <i>Numri i personave të dyshuar – në raport me numrin e banorëve...</i> .....	21
1.5 Konstatime.....	22
1.6 Rekomandime.....	22
2 PRIZRENI.....	23
2.1 Demografia.....	23
2.2 Llojet e kriminalitetit.....	24
2.3 Pjesëmarrja në kriminalitet.....	25
2.4 Analizë krahasimore : <i>Numri i personave të dyshuar – në raport me numrin e banorëve...</i> .....	26
2.5 Konstatime.....	27
2.6 Rekomandime.....	27
3 PEJA.....	28
3.1 Demografia.....	28
3.2 Llojet e kriminalitetit.....	29
3.3 Pjesëmarrja në kriminalitet.....	30
3.4 Analizë krahasimore : <i>Numri i personave të dyshuar – në raport me numrin e banorëve...</i> .....	31
3.5 Konstatime.....	32
3.6 Rekomandime.....	32

4	<b>GJILANI</b> .....	33
4.1	Demografia.....	33
4.2	Llojet e kriminalitetit.....	34
4.3	Pjesëmarrja në kriminalitet.....	35
4.4	Analizë krahasimore : <i>Numri i personave të dyshuar – në raport me numrin e banorëve...</i>	36
4.5	Konstatime.....	37
4.6	Rekomandime.....	37
5	<b>MITROVICA</b> .....	38
5.1	Demografia.....	38
5.2	Llojet e kriminalitetit.....	39
5.3	Pjesëmarrja në kriminalitet.....	40
5.4	Analizë krahasimore : <i>Numri i personave të dyshuar – në raport me numrin e banorëve...</i>	41
5.5	Konstatime.....	42
5.6	Rekomandime.....	42
6	<b>FERIZAJ</b> .....	43
6.1	Demografia.....	43
6.2	Llojet e kriminalitetit.....	44
6.3	Pjesëmarrja në kriminalitet.....	45
6.4	Analizë krahasimore : <i>Numri i personave të dyshuar – në raport me numrin e banorëve...</i>	46
6.5	Konstatime.....	47
6.6	Rekomandime.....	47
7	<b>GJAKOVA</b> .....	48
7.1	Demografia.....	48
7.2	Llojet e kriminalitetit.....	49
7.3	Pjesëmarrja në kriminalitet.....	50
7.4	Analizë krahasimore : <i>Numri i personave të dyshuar – në raport me numrin e banorëve...</i>	51
7.5	Konstatime.....	51
7.6	Rekomandime.....	
<b>PJESA E TRETË</b>		
8	<b>SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E VEPRAVE PENALA KARAKTERISTIKE</b>	53
8.1	Armët.....	53
8.2	Drogat.....	54
8.3	Kontrabanda me migrant.....	55
8.4	Krimi organizuar.....	56
8.5	Korrupsioni.....	57
8.6	Shpërlarja e parasë.....	58
8.7	Trafikimi me qenie njerëzore.....	59
8.8	Krimet ekonomike.....	60
8.9	Nxitja urrejtjes.....	61

## HYRJE

Raporti prezanton shpërndarjen dhe përhapjen e kriminalitetit në shtatë (7) regjione, të kategorizuara në bazë të kompetencës territoriale të shtatë (7) Prokurorive Themelore të Republikës së Kosovës.

Objekt i analizës së këtij raporti janë kryesit e veprave penale karakteristike përgjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015. Veprat penale të përfshira në këtë raport përbëjnë tërësinë e veprave penale të “Mekanizmit përcjellës” ndërinstitucional, të kategorizuara në nëntë (9) grupe karakteristike.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, ka publikuar raportet vjetore (2013, 2014 dhe 2015) të Mekanizmit përcjellës, duke pasqyruar aspektin sasior të kallëzimeve penale, informatave dhe personave të përfshirë. Mbi të dhënat sasiore të viteve respektive, në këtë raport pasqyrohet shpërndarja e veprave penale sipas hapësirës territoriale regjionale.

Në pjesën informuese të këtij raporti, pasqyrohet objekti i raportit, si dhe klasifikimi dhe kategorizimi i veprave penale karakteristike.

Pjesa e parë e raportit përmban të dhëna lidhur me numrin e përgjithshëm të banorëve resident në Republikën e Kosovës si dhe numrin e banorëve resident të përgjegjshëm penalisht, pra të banorëve të cilët kanë mbushur katërmëdhjetë (14) vjeç dhe mbi, këtë moshë. Gjithashtu, në këtë pjesë të raportit pasqyrohet përhapja gjeografike e kriminalitetit në Republikën e Kosovës, duke përfshirë pjesëmarrjen sasiore të personave në kriminalitet, sipas viteve. Pjesa analitike konsiston në krahasimin personave të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike në raport me numrin e banorëve, sipas regjioneve. Në përmbllje të pjesës së parë të raportit, pasqyrohen të gjeturat dhe rezultatet të përmbledhura në konstatime dhe rekomandime.

Demografia dhe përhapja gjeografike e kriminalitetit sipas regjioneve, respektivisht kompetencës territoriale të Prokurorive Themelore pasqyrohet në pjesën e dytë të këtij raporti. Gjithashtu, në këtë pjesë diskutohet edhe për pjesëmarrjen sasiore të kryesve në kriminalitet, sipas viteve. Pjesë e rëndësishme është analiza krahasimore e numrit të personave të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike në raport me numrin e banorëve, sipas regjioneve. Mbi bazën e të gjeturave dhe rezultateve, është realizuar përmbledhje e konkluzioneve dhe rekomandimeve për të gjitha Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovës.

Pjesa e tretë dhe e fundit të këtij raporti, reflekton shpërndarjen dhe përhapjen gjeografike të veprave penale karakteristike.

Në përfundim, theksojmë se ky raport përmes pasqyrimin të kriminalitetit në hapësirën territoriale (regjioneve) ka për qëllim që përmes njohjes së llojeve të kriminalitetit nëpër regjione, të ndikoj në ngritjen e kapaciteteve të sistemit prokurorial të Kosovës në përgjithësi, dhe të prokurorive themelore në veçanti, në luftimin e llojeve të kriminalitetit (veprave penale karakteristike), të identifikuar për çdo regjion, përmes këtij raporti.

## A. OBJEKTI I RAPORTIT

Objekt i këtij raporti janë kryesit e veprave penale të caktuara dhe kategorizuara në nëntë (9) grupe të veprave penale karakteristike, duke përfshirë: (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabandimin me migrant, (4) Krimin e organizuar, (5) Korrupsionin, (6) Shpërlarjen e parasë, (7) Trafikimin me qenie njerëzore, (8) Krimet ekonomike dhe (9) Nxitjen e urrejtjes.

Këto grupe të veprave penale karakteristike përbëjnë “Mekanizmin përcjellës” ndërinstitucional për harmonizimin e raporteve statistikore në mes subjekteve parashtruese të kallëzimeve penale, prokurorisë dhe gjykatave.

Mekanizmi përcjellës ndërinstitucional është krijuar me qëllim të harmonizimit të të dhënave në kuadër të zbulimit, hetimit, ndjekjes, gjykimit dhe ndëshkimit të kryesve të veprave penale karakteristike.

Analiza e të dhënave të këtij raporti është realizuar mbi të dhënat sasiore për veprat penale karakteristike, të viteve 2013, 2014 dhe 2015 dhe të gjeneruara dhe publikuara nga Këshilli Prokurorial i Kosovës në raportet vjetore të Mekanizmit përcjellës.

Theksojmë se, shtatë grupet e para të veprave penale karakteristike (1-7) janë regjistruar duke filluar nga viti 2013, ndërsa veprat penale të grupit të tetë (8) Krimet ekonomike janë regjistruar në Mekanizmin përcjellës në vitin 2014, dhe vepra penale e grupit (9) Nxitja e urrejtjes ka filluar të regjistrohet nga viti 2015.

Disa nga këto grupe të veprave penale karakteristike përmbajnë një numër më të madh të veprave penale, të përcaktuara me kodin e vjetër dhe me kodin e ri penal, ndërsa disa grupe përbëhen vetëm nga një vepër penale. Andaj, me qëllim të pasqyrimin të të gjitha veprave penale, sipas të dy kodeve, që përbëjnë mekanizmin përcjellës, në vazhdim ([pika B](#)) prezantohet kategorizimi i veprave penale në grupet e përcaktuara.

Me qëllim të realizimit të analizës krahasimore të objektit të këtij raporti, komunat e Republikës së Kosovës janë kategorizuar mbi bazën e kompetencës territoriale të shtatë (7) Prokurorive Themelore. Në këtë kontekst, përmes të dhënave statistikore nga regjistrimi i popullsisë së Kosovës, të vitit 2011, enkas për këtë analize janë konfiguruar komunat në kuadër të regjioneve, si dhe është kalkuar numri banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht, sipas klasifikimit në regjione.

## B. KLASIFIKIMI DHE KATEGORIZIMI I VEPRAVE PENALE KARAKTERISTIKE

Në tabelën në vazhdim pasqyrojmë veprat penale të cilat janë përfshirë në kuadër të grupeve të veprave penale karakteristike, që në tërësinë e tyre përbëjnë Mekanizmin përcjellës për harmonizimin ndër-institucional të raporteve statistikore. Në këtë tabelë pasqyrohen veprat penale sipas neneve respektive të kodit të vjetër dhe kodit të ri penal të Republikës së Kosovës.

Nenet sipas kodit të ri dhe të vjetër penal:	<b>CILËSIMI I VEPRAVE PENALE SIPAS KALLËZIMIT PENAL</b>
--	---

<b>Veprat penale që përbëjnë grupin e ARMËVE (shkurtesa "A")</b>	
Kodi ri-neni: 372 Kodi vjetër-neni:327	Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse
<b>Veprat penale që përbëjnë grupin e DROGAVE (shkurtesa "DR")</b>	
K.Ri _273 & K.Vj _229	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge
K.Ri _274 & K.Vj _230	Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike
K.Ri _275	Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge
K.Ri _276	Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope
K.Ri _277 & K.Vj _231	Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge
K.Ri _278	Kultivimi i bimës së hashashit, shkurrese së kokainës ose bimëve të kanabisit
K.Ri _279	Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope
K.Ri _280	Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull
<b>Veprat penale që përbëjnë grupin e KONTRABANDIMIT ME MIGRANT (shkurtesa "KM")</b>	
K.Ri _170 & K.Vj _138	Kontrabandimi me migrantë
<b>Veprat penale që përbëjnë grupin e KRIMIT TË ORGANIZUAR (shkurtesa "KO")</b>	
K.Ri _283 & K.Vj _274	Pjesëmarrja ose organizimi i grupit Kriminal të organizuar
<b>Veprat penale që përbëjnë grupin e KORRUPSIONIT (shkurtesa "KORR")</b>	
K.Ri _290	Keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike
K.Ri _291	Lidhja e kontratës së dëmshme

K.Ri_316	Dhënia e paarsyeshme e dhuratave
K.Ri_422 & K.Vj_339	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar
K.Ri_423	Keqpërdorimi i informatës zyrtare
K.Ri_424	Konflikti i interesit
K.Ri_425 & K.Vj_340	Përvetësimi në detyrë
K.Ri_426 & K.Vj_341	Mashtrimi në detyrë
K.Ri_427 & K.Vj_342	Përdorimi i paautorizuar i pasurisë
K.Ri_428 & K.Vj_343	Marrja e ryshfetit
K.Ri_429 & K.Vj_344	Dhënia e ryshfetit
K.Ri_430	Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj
K.Ri_431 & K.Vj_345	Ushtrimi i ndikimit
K.Ri_432 & K.Vj_346	Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore
K.Ri_433 & K.Vj_347	Zbulimi i fshehtësisë zyrtare
K.Ri_434 & K.Vj_348	Falsifikimi i dokumentit zyrtar
K.Ri_435 & K.Vj_349	Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme
K.Ri_436 & K.Vj_351	Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor
K.Ri_437	Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare
K.Vj_350	Lirimi i kundërligjshëm i personit të privuar nga liria
<b>Veprat penale që përbëjnë grupin e SHPËRLARJES SË PARAVE (shkurtesa "SHP")</b>	
K.Ri_308 & L-Nr.03 /L-196 & Rreg. UNMIK	Shpërlarja e Parave
<b>Veprat penale që përbëjnë grupin e TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE (shkurtesa "TNJ")</b>	
K.Ri_171 & K.Vj_139	Trafikimi me njerëz

<b>Veprat penale që përbëjnë grupin e KRIMEVE EKONOMIKE (shkurtesa "E")</b>	
K. Ri_284	Cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike
K. Ri_285	Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike
K. Ri_286	Shkaktimi i falimentimit
K. Ri_287	Shkaktimi i falimentimit të rrejshëm
K. Ri_288	Mashtrimi në procedurën e falimentimit
K. Ri_289	Mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve
K. Ri_292	Komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar
K. Ri_293	Falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës
K. Ri_294	Falsifikimi i shenjave me vlerë
K. Ri_295	Cenimi i të drejtave të patentës

K. Ri_296	Cenimi i të drejtave të autorit
K. Ri_297	Shmangja e masave teknologjike
K. Ri_298	Mashtrimi i konsumatorëve
K. Ri_299	Mashtrimi i blerësve
K. Ri_300	Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm
K. Ri_301	Keqpërdorimit i pozitës së monopolit
K. Ri_302	Falsifikimi i parasë
K. Ri_303	Prodhimi dhe përdorimi i shenjave të etiketimit, masave dhe peshave të rreme
K. Ri_304	Prodhimi, furnizimi, shitja, posedimi ose dhënia në shfrytëzim e mjeteve për falsifikim
K. Ri_305	Tregtia e ndaluar
K. Ri_306	Prodhimi i ndaluar
K. Ri_307	Lëshimi çëqeve pa mbulesë ose të rreme dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo kreditit
K. Ri_309	Marrëveshja për kufizimin e konkurenës përmes ftesave për tender
K. Ri_310	Mashtrimi në shkëmbimin e letrave me vlerë
K. Ri_311	Keqpërdorimi i informatave të brendshme
K. Ri_312	Marrëveshja dhe mashtrimi me letrat me vlerë të Qeverisë
K. Ri_313	Shmangja nga tatimi
K. Ri_314	Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin
K. Ri_315	Pranimi i paarsyeshëm i dhuratave
K. Ri_317	Kontrabandimi i mallrave
K. Ri_318	Shmangja nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore
<b>Veprat penale që përbëjnë grupin e NXITJES SË URREJTJES (shkurtesa "NU")</b>	
K. Ri_147	<i>Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik</i>



## PJESA E PARË

### I. DEMOGRAFIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në Republikën e Kosovës jetojnë **1.739,825** banorë resident<sup>1</sup>, prej të cilëve **487,577** banorë i takojnë moshës deri në 14 vjeç, ndërsa **1,252,248** banorë i takojnë janë të moshës 14 dhe mbi vjeçare. Theksojmë se **1.252,248** banorë i takojnë moshës 14 vjeçare e mbi dhe janë penalisht të përgjegjshëm, andaj edhe analizat lidhur me shtrirjen gjeografike të kriminalitetin, objekt i raportit, janë të bazuara mbi këtë numër të banorëve.

Të dhënat mbi numrin e banorëve resident në komunat të cilat i përkasin territorit të kompetencës së prokurorive, pasqyrohen në tabelën në vazhdim. (shih figurën 1).

Regjioni	Numri i popullsisë	0 - nën 14 vjeç <sup>2</sup>	14 - 64 vjeç	Mbi 65 vjeç	Penalisht të përgjegjshëm
1 Prishtinë	470,583	131,779	309,438	29,366	338,804
2 Prizren	277,007	77,092	181,027	18,888	199,915
3 Pejë	220,338	59,352	144,521	16,465	160,986
4 Gjakovë	205,377	60,221	131,751	13,405	145,156
5 Gjilan	188,188	49,840	124,032	14,316	138,348
6 Mitrovicë	192,637	55,016	124,562	13,059	137,621
7 Ferizaj	185,695	54,277	120,132	11,286	131,418
Gjithsej:	1.739,825	487,577	1.135,463	116,785	1.252,248

Figura 1

Në hapësirën territoriale të kompetencës së Prokurorisë Themelore të Prishtinës banojnë 27% të banorëve nga numri i përgjithshëm i banorëve resident në Republikën e Kosovës, të përgjegjshëm penalisht, ndërsa pjesëmarrja përqindja e banorëve nëpër hapësirat territoriale të kompetencës së Prokurorive tjera pasqyrohet në grafikonin në vazhdim (shih figurën 2):




Figura 2

<sup>1</sup> Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës<sup>1</sup>, të regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, përveç komunave: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicën e Veriut.

<sup>2</sup> Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërbëdhjetë (14) vjet. Neni 17.3 i Kodit Penal të Kosovës.

## II. PËRHAPJA GJEOGRAFIKE E KRIMINALITETIT

Përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015) gjithsej **7,518** persona janë proceduar në prokurori për përfshirjen e tyre në kallëzimet penale për ndonjëren nga veprat penale karakteristike<sup>3</sup>, që përbën **0.60%** të numrit të banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht në Republikën e Kosovës.

Numri i personave të kategorizuar sipas llojit të veprave penale dhe prokurorive pasqyrohet në tabelën në vazhdim (shih figurën 3).

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE	VITI	PSRK	PRISHTINË	PRIZREN	PEJË	GJILAN	MITROVICË	FERIZAJ	GJAKOVË	TOTALI
ARMËT	2013	9	20	19	1	13	0	8	0	70
	2014	4	10	13	0	6	0	3	8	44
	2015	3	6	6	2	0	0	1	1	19
DROGAT	2013	24	238	111	58	60	55	52	18	616
	2014	38	267	139	80	75	53	93	48	793
	2015	9	213	127	60	41	130	47	27	654
KONTRABANDA ME MIGRANT	2013	45	28	13	0	24	0	16	3	129
	2014	42	26	5	5	24	7	3	6	118
	2015		38	16	4	13	12	1	2	86
KRIMI ORGANIZUAR	2013	92								92
	2014	161	4							165
	2015	156								156
KORRUPSIONI	2013	35	404	151	129	112	59	98	58	1046
	2014	156	403	124	86	75	69	60	38	1011
	2015	52	351	101	71	66	93	64	62	860
SHPËRLARJA E PARASË	2013	32		4						36
	2014	25								25
	2015	25		2						27
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	2013	2	44	7	3	6	9	25	15	111
	2014	13	20	7	11	5	16	17	4	93
	2015		25	7	3	4	8	13	7	67
KRIMET EKONOMIKE	2013									
	2014	2	297	111	33	72	114	81	27	737
	2015	7	26	109	34	32	202	104	11	525
NXITJA URREJTJES	2013									
	2014									
	2015	23		2	4		3	6		38
<b>TOTAL</b>		<b>955</b>	<b>2420</b>	<b>1074</b>	<b>584</b>	<b>628</b>	<b>830</b>	<b>692</b>	<b>335</b>	<b>7518</b>

Figura 3

<sup>3</sup> Armët, Drogat, Kontrabandimin me migrantë, Krimin e organizuar, Korrupsionin, Shpërlarjen e parasë, Trafikimin me qenie njerëzore, Krimet ekonomike dhe Nxitjen e urrejtjes.

Prokuroritë Themelore të Republikës së Kosovës<sup>4</sup>, përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015) kanë proceduar me **6,563** persona të përfshirë në kallëzime penale në shtatë (7) grupet e veprave penale karakteristike<sup>5</sup> (shih tabelën 4), ndërsa sipas kompetencës së prokurorive:

- **PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË**, që përfshinë hapësirën territoriale të komunave në kompetencë, gjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) ka proceduar me **2,420** persona, që përbën **0.71%** të numrit të banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht;
- **PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN**, që përfshinë hapësirën territoriale të komunave në kompetencë, gjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) ka proceduar me **1,074** persona, që përbën **0.53%** të numrit të banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht;
- **PROKURORIA THEMELORE NË MITROVICË**, që përfshinë hapësirën territoriale të komunave në kompetencë, gjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) ka proceduar me **830** persona, që përbën **0.60%** të numrit të banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht;
- **PROKURORIA THEMELORE NË FERIZAJ**, që përfshinë hapësirën territoriale të komunave në kompetencë, gjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) ka proceduar me **692** persona, që përbën **0.52%** të numrit të banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht;
- **PROKURORIA THEMELORE NË GJILAN**, që përfshinë hapësirën territoriale të komunave në kompetencë, gjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) ka proceduar me **628** persona, që përbën **0.45%** të numrit të banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht.
- **PROKURORIA THEMELORE NË PEJË**, që përfshinë hapësirën territoriale të komunave në kompetencë, gjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) ka proceduar me **584** persona, që përbën **0.36%** të numrit të banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht;
- **PROKURORIA THEMELORE NË GJAKOVË**, që përfshinë hapësirën territoriale të komunave në kompetencë, gjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) ka proceduar me **335** persona, që përbën **0.23%** të numrit të banorëve resident, të përgjegjshëm penalisht.

#	Klasifikimi i personave sipas kompetencës territoriale të prokurorive themelore	2013	2014	2015	(2013, 2014, 2015)
1	PRISHTINA	734	1,027	659	<b>2,420</b>
2	PRIZRENI	305	399	370	<b>1,074</b>
3	MITROVICA	123	259	448	<b>830</b>
4	FERIZAJI	199	257	236	<b>692</b>
5	GJILANI	215	257	156	<b>628</b>
6	PEJA	191	215	178	<b>584</b>
7	GJAKOVA	94	131	110	<b>335</b>
8	Prokuroritë Themelore (1 deri 7)	<b>1861</b>	<b>2,545</b>	<b>2157</b>	<b>6,563</b>
9	Prokuroria Speciale	239	441	275	<b>955</b>
<b>Gjithsej (Nr.8 + Nr.9)</b>		<b>2100</b>	<b>2,986</b>	<b>2432</b>	<b>7,518</b>

Figura 4

<sup>4</sup> Në përlllogaritjen e personave të përfshirë në veprat penale sipas hapësirës territoriale nuk përfshihet Prokuroria Speciale, meqenëse kjo prokurori ka kompetence territoriale në tërë Kosovën, andaj edhe personat e përfshirë në kallëzimet penale të kësaj prokurorieje mund të jenë të të gjitha regjioneve.

<sup>5</sup> Krimet ekonomike dhe nxitja urrejtjes në vitin 2013 nuk kanë qenë pjesë e Mekanizmit përcjellës.

Sipas përqindjes së pjesëmarrjes së personave në kallëzime penale për veprat penale karakteristike, sipas ndarjes territorial (shih figurën 5) - Në raport me numrin e përgjithshëm të personave të përfshirë në veprat penale karakteristike përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015), rezulton të jetë si në vazhdim:

- **PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË**, me gjithsej 2,420 persona të përfshinë në kallëzime penale për veprat penale karakteristike, që përbën **36.8%** të numrit të përgjithshëm të personave nga numri i përgjithshëm prej 6.563 personave të përfshirë në kallëzimet penale të Prokurorive Themelore;
- **PROKURORIA THEMELORE NË PRIZREN**, me gjithsej 1,074 persona të përfshinë në kallëzime penale për veprat penale karakteristike, që përbën **16.3%** të numrit të përgjithshëm të personave nga numri i përgjithshëm prej 6.563 personave të përfshirë në kallëzimet penale të Prokurorive Themelore.
- **PROKURORIA THEMELORE NË MITROVICË**, me gjithsej 830 persona të përfshinë në kallëzime penale për veprat penale karakteristike, që përbën **12.6%** të numrit të përgjithshëm të personave nga numri i përgjithshëm prej 6.563 personave të përfshirë në kallëzimet penale të Prokurorive Themelore.
- **PROKURORIA THEMELORE NË FERIZAJ**, me gjithsej 692 persona të përfshinë në kallëzime penale për veprat penale karakteristike, që përbën **10.5%** të numrit të përgjithshëm të personave nga numri i përgjithshëm prej 6.563 personave të përfshirë në kallëzimet penale të Prokurorive Themelore.
- **PROKURORIA THEMELORE NË GJILAN**, me gjithsej 628 persona të përfshinë në kallëzime penale për veprat penale karakteristike, që përbën **9.5%** të numrit të përgjithshëm të personave nga numri i përgjithshëm prej 6.563 personave të përfshirë në kallëzimet penale të Prokurorive Themelore.
- **PROKURORIA THEMELORE NË PEJË**, me gjithsej 584 persona të përfshinë në kallëzime penale për veprat penale karakteristike, që përbën **8.8%** të numrit të përgjithshëm të personave nga numri i përgjithshëm prej 6.563 personave të përfshirë në kallëzimet penale të Prokurorive Themelore.
- **PROKURORIA THEMELORE NË GJAKOVË**, me gjithsej 335 persona të përfshinë në kallëzime penale për veprat penale karakteristike, që përbën **5.1%** të numrit të përgjithshëm të personave nga numri i përgjithshëm prej 6.563 personave të përfshirë në kallëzimet penale të Prokurorive Themelore.




Figura 5

Nga të dhënat e analizuara rezultojnë se Prokuroritë Themelore në Republikën e Kosovës përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015) kanë proceduar me gjithsej 6,563 persona të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike, ndërsa Prokuroria Speciale ka proceduar me 955 persona, që në total rezultojnë se 7,518 persona kanë qenë të përfshirë në kallëzimet penale për tre vite (pëmbledhje) për veprat penale karakteristike.

Nga analizimi i pjesëmarrjes së personave në veprat penale në kuadër të numrit të përgjithshëm prej 6,563 personave, vetëm nëpër prokuroritë themelore, rezultojnë se:

- **PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË** rezultojnë të ketë pjesëmarrjen më të lartë **36.87%** të personave (**2,420 persona**) të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike, nga numri i përgjithshëm prej **6,563** personave të përfshirë në kallëzimet penale në të gjitha Prokuroritë Themelore, duke përjashtuar Prokurorinë Speciale (**me 955 persona**).
- **PROKURORIA THEMELORE NË GJAKOVË** rezultojnë të ketë pjesëmarrjen më të ulët **5.10%** të personave (**335 persona**) të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike, nga numri i përgjithshëm prej **6,563** personave të përfshirë në kallëzimet penale në të gjitha Prokuroritë Themelore, duke përjashtuar Prokurorinë Speciale (**me 955 persona**).

Pjesëmarrja e personave të përfshirë në kallëzimet penale për veprat penale karakteristike sipas kategorizimit të Prokurorive Themelore pasqyrohet në tabelën në vazhdim (**shih figurën 6**).

#	Regjioni/ Prokuroria	Numri personave të përfshirë në kallëzimet penale, për veprat penale karakteristike, për tre (3) vite në total:	Përqindja e pjesëmarrjes së Prokurorisë me persona- Në raport me nivelin e Republikës
1	PRISHTINË	2,420	36.87%
2	PRIZREN	1,074	16.36%
3	MITROVICË	830	12.64%
4	FERIZAJ	692	10.54%
5	GJILAN	628	9.56%
6	PEJË	584	8.89%
7	GJAKOVË	335	5.10%
<b>Gjithsej:</b>		<b>6,563</b>	<b>100%</b>
Prokuroria Speciale		<b>955</b>	
Numri përgjithshëm i rasteve për persona në nivel Republike		<b>7,518</b>	

Figura 6

Në bazë të të dhënave të gjeneruara nga baza e të dhënave të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për personat e përfshirë në kallëzimet penale përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) për veprat penale karakteristike, rezultojnë se pesë (5) regjione: Prishtina, Gjlani, Ferizaj, Gjakova dhe Peja kanë numrin më të madh të personave të përfshirë në grupin e veprave penale të Korrupsionit. Regjioni i Prizrenit rezultojnë të ketë numrin më të madh të personave të përfshirë në kallëzimet penale për tre vite (2013, 2014, 2015) për veprat penale të Drogave. Ndërsa, Regjioni i Mitrovicës rezultojnë të ketë numrin më të madh të personave të përfshirë në kallëzimet penale për tre vite (2013, 2014, 2015) për veprat penale të Krimeve ekonomike, edhe pse ky grup i veprave penale ka të regjistruar veprat penale vetëm për dy (2) vite, dhe si i tillë i ka tejkalar veprat tjera penale karakteristike të cilat janë regjistruar për tre (3) vite.

Në figurën në vazhdim, pasqyrohet harta regionale e Kosovës, e kategorizuar sipas numrit më të lartë të personave të përfshirë në kallëzimet penale për llojet e veprave penale karakteristike, përgjatë viteve: 2013, 2014 dhe 2015 (shih figurën 7):




Figura 7

### III. PJESËMARRJA NË KRIMINALITET

Subjektet parashtruese të Kallëzimeve penale<sup>6</sup>, në vitin **2013** kanë proceduar në prokurori **2,100** persona të përfshirë në kallëzimet penale të shtatë (7) grupeve të veprave penale karakteristike<sup>7</sup>, që përbën **0.16%** të numrit të banorëve, të moshës me përgjegjësi penale, të dyshuar për kryerjen e veprës penale.

Subjektet parashtruese të Kallëzimeve penale, në vitin **2014** kanë proceduar në prokurori **2,986** persona të përfshirë në kallëzimet penale të tetë (8) grupeve të veprave penale karakteristike<sup>8</sup>, që përbën **0.23%** të numrit të banorëve, të moshës me përgjegjësi penale, të dyshuar për kryerjen e veprës penale.

Subjektet parashtruese të Kallëzimeve penale, në vitin **2015** kanë proceduar në prokurori **2,432** persona të përfshirë në kallëzimet penale të nëntë (9) grupeve të veprat penale karakteristike<sup>9</sup>, që përbën **0.19%** të numrit të banorëve, të moshës me përgjegjësi penale, të dyshuar për kryerjen e veprës penale.

Subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015) kanë proceduar në prokurori **7,518** persona të përfshirë në kallëzime penale për veprat penale karakteristike. Ky numër i personave të përfshirë në kallëzime penale, përbën **0.43%** të numrit të banorëve resident në nivel nacional apo **0.60%** të numrit të banorëve të moshës me përgjegjësi penale, të dyshuar për kryerjen e veprave penale, të cilat të kategorizuara sipas llojit të veprave penale dhe viteve, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 8).

#	VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE	2013	2014	2015	2013, 2014, 2015
		PERSONA	PERSONA	PERSONA	PERSONA
1	ARMËT	70	44	19	133
2	DROGA	616	793	654	2063
3	KONTRABANDIMI ME MIGRANTË	129	118	86	333
4	KRIMI ORGANIZUAR	92	165	156	413
5	KORRUPSIONI	1046	1011	860	2917
6	SHPËRLARJA PARASË	36	25	27	88
7	TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	111	93	67	271
8	KRIMET EKONOMIKE	-	737	525	1262
9	NXITJA URREJTJES	-	-	38	38
		<b>2100</b>	<b>2986</b>	<b>2432</b>	<b>7518</b>

Figura 8

<sup>6</sup> Policia e Kosovës, Agjencioni kundër korrupsionit; Dogana e Kosovës; Eulex; Administrata Tatimore e Kosovës; Inspektoriati Policor i Kosovës; Njësia e Inteligjencës Financiare; Zyra e Auditorit Gjeneral; Autoriteti Pyjor i Kosovës; Agjencioni Kosovar i Pronës; Organi i Administratës Komunale; i Dëmtuari; Prokurori me vetiniciativë; E pranuar në Kompetencë dhe Qytetari.

<sup>7</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabanda me migrantë, (4) Krimi organizuar, (5) Korrupsioni, (6) Shpërlarja e parasë, (7) Trafikimi me njerëz.

<sup>8</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabanda me migrantë, (4) Krimi organizuar, (5) Korrupsioni, (6) Shpërlarja e parasë, (7) Trafikimi me njerëz dhe (8) Krimet ekonomike.

<sup>9</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabanda me migrant, (4) Krimi organizuar, (5) Korrupsioni, (6) Shpërlarja e parasë, (7) Trafikimi me njerëz, (8) Krimet ekonomike dhe (9) Nxitja e urrejtjes.

#### IV. ANALIZË KRAHASIMORE: NUMRI PERSONAVE TË DYSHUAR- NË RAPORT ME NUMRIN E BANORËVE

Në bazë të të dhënave<sup>10</sup> rezulton se **7,518** persona kanë qenë të përfshirë në veprat penale karakteristike<sup>11</sup> përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015), që në përpjestim me **1,252,248** banorë të Kosovës<sup>12</sup>, të përgjegjshëm penalisht<sup>13</sup>, rezulton se një person në çdo **166** banorë ka qenë i përfshirë në ndonjëren prej veprave penale karakteristike, për tre vite (shih figurën 9).

VEPRAT PENALE KARAKTERISTIKE	2013	2014	2015	Total:(2013, 2014, 2015)	
	Persona	Persona	Persona	Persona	M
ARMËT	70	44	19	133	9,415
DROGA	616	793	654	2063	607
KONTR. MIGRANT	129	118	86	333	3,760
KRIMI ORGANIZUAR	92	165	156	413	3,032
KORRUPSIONI	1046	1011	860	2917	429
SHPËRLARJA PARASË	36	25	27	88	14,230
TRAFIK. ME NJERËZ	111	93	67	271	4,620
KRIMET EKONOMIKE	-	737	525	1262	992
NXITJA URREJTJES	-	-	38	38	32,953
GJITHSEJ	2100	2986	2432	7,518	166

Figura 9

Përqindja e pjesëmarrjes së personave në nivel vendi, në veprat penale karakteristike gjatë viteve 2013, 2014, 2015 pasqyrohet përmes grafikoneve në vazhdim (shih figurën 10):




Figura 10

<sup>10</sup> Të dhënat nga baza e të dhënave të "Mekanizmit përcjellës" të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

<sup>11</sup> Armët, Drogat, Kontrabanimi me migrant, Krimi organizuar, Korruptsionit, Shpërlarja e parasë, Trafikimi me qenie njerëzore, Krimet ekonomike dhe Nxitja urrejtjes.

<sup>12</sup> Regjistrimi i popullsisë së Kosovës në vitin 2011, nga Agjencia Statistikave të Kosovës.

<sup>13</sup> Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet. Neni 17.3 i Kodit Penal të Kosovës.



## V. KONSTATIME

1. Në vitin 2013, një (1) person në 596 banorë (*penalisht të përgjegjshëm në nivel vendi*) ka qenë i përfshirë në njëren nga veprat penale karakteristike;
2. Në vitin 2014, një (1) person në 419 banorë (*penalisht të përgjegjshëm në nivel vendi*) ka qenë i përfshirë në njëren nga veprat penale karakteristike;
3. Në vitin 2015, një (1) person në 514 banorë (*penalisht të përgjegjshëm në nivel vendi*) ka qenë i përfshirë në njëren nga veprat penale karakteristike;
4. Pjesëmarrjen sasiore më të lartë të personave të përfshirë në veprat penale, gjatë tre viteve rezulton të ketë vepra penale e **Korrupsionit**, respektivisht:
  - i. Në vitin 2013, një (1) person në 1,197 banorë, penalisht të përgjegjshëm në nivel vendi;
  - ii. Në vitin 2014, një (1) person në 1,238 banorë, penalisht të përgjegjshëm në nivel vendi;
  - iii. Në vitin 2015, një (1) person në 1,456 banorë, penalisht të përgjegjshëm në nivel vendi;
5. Pjesëmarrjen sasiore më të ulët të personave të përfshirë në kallëzime penale në vitin 2013 rezulton të ketë vepra penale e **Shpërlarjes së parasë**, me një (1) person në 34,784 banorë penalisht të përgjegjshëm, në nivel Republike;
6. Numrin më të ulët të personave të përfshirë në kallëzime penale në vitin 2014 rezulton të ketë vepra penale e **Shpërlarjes së parasë**, me një (1) person në 50,089 banorë penalisht të përgjegjshëm, në nivel Republike;
7. Numrin më të ulët të personave të përfshirë në kallëzime penale në vitin 2015 rezulton të ketë vepra penale e **Armëve**, me një (1) person në 65,907 banorë penalisht të përgjegjshëm, në nivel Republike;

## VI. REKOMANDIME:

1. Ngritja e efikasitetit në luftimin e veprave penale të (1) Korrupsionit, (2) Drogave dhe (3) Krimeve ekonomike, meqenëse këto vepra penale përbëjnë numrin më të madh në raport me tërësinë e personave të përfshirë në veprat penale karakteristike në nivel vendi;
2. Profilizimi i prokurorëve në raport me llojet e veprat penale karakteristike, të cilat bartin ndjeshmërinë më të lartë publike dhe ndërkombëtare, për sistemin prokurorial.
3. Angazhim i shtuar në lëndët (Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike) që trajtojnë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

## PJESA E DYTË

### KRIMINALITETI SIPAS REGJIONEVE

#### 1. PRISHTINA

##### 1.1 DEMOGRAFIA

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, rezulton se territori i Prishtinës që përfshinë shtatë komuna (1) Prishtinë; (2) Podujevë; (3) Drenas; (4) Lipjan; (5) Fushë Kosovë; (6) Obiliq dhe (7) Graçanicë, numëron 470,583 banorë resident prej të cilëve 338,804 rezulton të jenë mbi moshën 14 vjeçare, të cilët janë të përgjegjshëm penalisht. Të dhënat sasiore të shtatë (7) komunave, të klasifikuara sipas numrit të banorëve resident dhe të përgjegjshëm penalisht, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 11).

Konstatohet se Prokuroria Themelore në Prishtinë ka kompetencë territoriale në shtatë komunat që përbëjnë regjionin e Prishtinës me numrin e përgjithshëm prej 338,804 banorëve të përgjegjshëm penalisht.

REGJIONI I PRISHTINËS				
Hapësira territoriale e kompetencës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, numri i banorëve resident dhe numri i banorëve penalisht të përgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm penalisht.				
Komunat	Numri i banorëve resident	Nr.Banorëve Penalisht të pa-përgjegjshëm (-14 vjeç)	Nr.Banorëve Penalisht të përgjegjshëm (+14 vjeç)	
1 Prishtinë	198,897	51,400	147,494	
2 Podujevë	88,499	26,808	61,691	
3 Drenas	58,531	17,295	41,236	
4 Lipjan	57,605	17,195	40,410	
5 F. Kosovë	34,827	9,996	24,831	
6 Obiliq	21,549	6,419	15,130	
7 Graçanicë	10,675	2,663	8,012	
<b>Totali:</b>	<b>470.583</b>	<b>131,779</b>	<b>338,804</b>	



Hapësira territoriale e regjionit të Prishtinës

Figura 11

Theksojmë se **131,779** banorë të regjionit të Prishtinës i takojnë moshës nën 14 vjeçare dhe të njëjtin nuk janë të përgjegjshëm penalisht<sup>14</sup>.

<sup>14</sup> Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet. Neni 17.3 i Kodit Penal të Kosovës.

## 1.2 LLOJET E KRIMINALITETIT

Nga numri i përgjithshëm prej **338,804** banorëve të përgjegjshëm penalisht në regjionin e Prishtinës, përgjatë viteve (2013, 2014, 2015) **2,420** persona (banorë) janë proceduar në prokurori për shtatë (7) grupe të veprave penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës<sup>15</sup>, që përbën **0.71%** të numrit të përgjithshëm banorëve, të përgjegjshëm penalisht, në regjionin e Prishtinës. Konstatohet se çdo i 140 banorë i përgjegjshëm penalisht, ka qenë i përfshirë në njëren prej veprave penale karakteristike përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015).

Nga numrin e përgjithshëm prej 2,420 personave të përfshirë në kallëzimet penale, përgjatë tre viteve, sipas llojit të veprës penale, rezulton se: 36 persona kanë qenë të përfshirë në veprat penale të Armëve; 718 persona për Droga; 92 persona për Kontrabandim me migrant; 4 persona për Krim të organizuar; 1,158 persona për Korrupsion; 89 persona për trafikim me qenie njerëzore dhe 323 persona për krime ekonomike (shih figurën 12):

VEPRA PENALE KARAKTERISTIKE PRISHTINA	VITI	PERSONA TË PËRFSHIRË NË KALLËZIME PENALE	TOTALI PËR 3 VITE	Pjesëmarrja e veprës penale, me përqindje
ARMËT	2013	20	36	1.48%
	2014	10		
	2015	6		
DROGAT	2013	238	718	29.66%
	2014	267		
	2015	213		
KONTRABANDA ME MIGRANT	2013	28	92	3.80%
	2014	26		
	2015	38		
KRIMI ORGANIZUAR	2013		4	0.16%
	2014	4		
	2015			
KORRUPSIONI	2013	404	1,158	47.85%
	2014	403		
	2015	351		
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	2013	44	89	3.67
	2014	20		
	2015	25		
KRIMET EKONOMIKE	2013		323	13.34
	2014	297		
	2015	26		
<b>TOTAL</b>		<b>2,420</b>	<b>2,420</b>	<b>100%</b>

Figura 12

<sup>15</sup> (1) Armët, (2) Droga, (3) Kontrabandimi me migrantë, (4) Krimi organizuar (5) Korrupsioni, (6) Trafikimi me qenie njerëzore dhe (7) Krimet ekonomike.

### 1.3 PJESËMARRJA NË KRIMINALITET

Në vitin **2013**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale kanë parashtruar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë **734** persona të përfshirë në kallëzimet penale për shtatë (7) grupet e veprave penale karakteristike<sup>16</sup>, që përbën **0.21%** të numrit të përgjithshëm të banorëve penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Prishtinës.

Në vitin **2013**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale kanë parashtruar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë **1,027** persona të përfshirë në kallëzimet penale për shtatë (7) grupet e veprave penale karakteristike, që përbën **0.30%** të numrit të përgjithshëm të banorëve penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Prishtinës.

Në vitin **2013**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale kanë parashtruar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë **659** persona të përfshirë në kallëzimet penale për shtatë (7) grupet e veprave penale karakteristike, që përbën **0.19%** të numrit të përgjithshëm të banorëve penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Prishtinës.

Numri i përgjithshëm prej **2,420** personave të përfshirë të kallëzimeve penale përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015), përbën **0.43%** të numrit të banorëve resident apo **0.71%** të numrit të banorëve të moshës me përgjegjësi penale, të dyshuar për kryerjen e veprave penale. Ndërsa pjesëmarrja e personave sipas kategorizimit të veprës penale pasqyrohet në hartën (e dizajnuar enkas) territoriale të Kompetencës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë (shih figurën 13).




Figura 13

<sup>16</sup> Prokuroria Themelore në Prishtinë përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) nuk ka proceduar me asnjë person për veprën penale të Shpërlarjes së parasë dhe të nxitjes së urrejtjes.

## 1.4 ANALIZË KRAHASIMORE: NUMRI PERSONAVE TË DYSHUAR- NË RAPORT ME NUMRIN E BANORËVE

Të dhënat sasiore lidhur me numrin e personave të përfshirë në kallëzimet penale sipas llojit të veprës penale karakteristike përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht në regjionin e Prishtinës, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 14).

Pjesëmarrja e një personi në kallëzim penal në raport me numrin e banorëve penalisht të përgjegjshëm						
Veprat penale karakteristike	2013		2014		2015	
	Persona në kallëzim penal	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Persona në veprën penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Persona në veprën penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal
Armët	20	16,940	10	33,880	6	56,467
Drogat	238	1,423	267	1,268	213	1,590
Kontrab. me migrant	28	12,100	26	13,030	38	8,915
Krimi organizuar			4	84,701		
Korrupsioni	404	838	403	840	351	965
Trafikimi me njerëz	44	7,700	20	16,940	25	13,552
Krimet ekonomike			297	1,140	26	13,030
<b>Gjithsej:</b>	<b>734</b>	<b>461</b>	<b>1027</b>	<b>329</b>	<b>659</b>	<b>514</b>

Figura 14

Përqindja e pjesëmarrjes së personave në veprat penale karakteristike, në regjionin e Prishtinës, gjatë viteve 2013, 2014, 2015 pasqyrohet përmes grafikoneve në vazhdim (shih figurën 15):




Figura 15

## 1.5 KONSTATIME

1. Në vitin 2013, një (1) person në **461** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Prishtinës, kanë qenë të përfshirë në veprat penale karakteristike;
2. Në vitin 2014, një (1) person në **329** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Prishtinës, kanë qenë të përfshirë në veprat penale karakteristike;
3. Në vitin 2015, një (1) person në **514** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Prishtinës, kanë qenë të përfshirë në veprat penale karakteristike;
4. Pjesëmarrjen sasiore më të lartë të personave të përfshirë në veprat penale, gjatë tre viteve rezulton të ketë vepra penale e **Korrupsionit**, respektivisht:
  - i. Në 2013, një (1) person në **838** banorë penalisht të përgjegjshëm;
  - ii. Në 2014, një (1) person në **840** banorë penalisht të përgjegjshëm;
  - iii. Në 2015, një (1) person në **965** banorë penalisht të përgjegjshëm;
5. Pjesëmarrjen sasiore më të ulët të personave të përfshirë në veprat penale, gjatë 3 viteve rezulton të kenë:
  - i. Në 2013, **Armët**, me një (1) person në **16,940** banorë, penalisht të përgjegjshëm;
  - ii. Në 2014, **Krimi organizuar** 1 person në **84,701** banorë, penalisht të përgjegjshëm;
  - iii. Në 2015, **Armët**, me një (1) person në **56,467** banorë, penalisht të përgjegjshëm;
8. Konstatojmë (sipas të dhënave preliminare) se Njësitë i posaçëm i PTh. Prishtinës, i themeluar në pajtim me strategjinë për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, ka rezultuar të ketë ndikuar pozitivisht në zgjidhjen/procedimin e kallëzimeve penale me persona për këto dy vepra penale.
9. Konstatojmë se me krijimin e njësitit të posaçëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, ka filluar profilizimi i prokurorëve për veprat penale të Korrupsionit dhe krimeve ekonomike, si dy lloje të veprave penale të cilat bartin ndjeshmërinë më të lartë publike për regjionin e Prishtinës, si dhe ndjeshmërinë ndërkombëtare, për sistemin prokuroria të Republikës së Kosovës.

## 1.6 REKOMANDIME:

1. Ngritja e efikasitetit në luftimin e veprave penale të (1) Korrupsionit, (2) Drogave dhe (3) Krimeve ekonomike, meqenëse këto vepra penale përbëjnë numrin më të madh të personave të përfshirë në kallëzime penale - në raport me tërësinë e veprave penale karakteristike në regjionin e Prizrenit. Profilizimi i prokurorëve për veprën penale të Trafikimit me qenie njerëzore, sepse **32.84%** të personave të përfshirë për këtë vepër penale gjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015) nga tërësia e personave të përfshirë në këtë vepër penale në nivelin nacional, rezultojnë të jenë në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.
2. Trajnimi i vazhdueshëm i prokurorëve të njësitit të posaçëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, respektivisht të prokurorëve në Njësitin e posaçëm për Krime të rënda dhe Prokurorëve në Njësitin e posaçëm të Krimeve të përgjithshme.
3. Angazhimi i shtuar në trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

## 2. PRIZRENI

### 2.1 DEMOGRAFIA

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, rezulton se territori i Prizrenit që përfshinë katër komuna (1) Prizreni; (2) Suhareka; (3) Dragashi; (4) Mamusha, numëron **277,007** banorë resident, prej të cilëve **199,915** rezultojnë të jenë mbi moshën 14 vjeçare, të cilët janë të përgjegjshëm penalisht. Të dhënat sasiore të katër (4) komunave, të klasifikuara sipas numrit të banorëve resident dhe të përgjegjshëm penalisht, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 16).

Theksojmë se Prokuroria Themelore në Prizren ka kompetencë territoriale në katër komunat që përbëjnë regjionin e Prizrenit me numrin e përgjithshëm prej **199,915** banorëve të përgjegjshëm penalisht.

REGJIONI I PRIZRENIT				
Hapësira territoriale e kompetencës së Prokurorisë Themelore në Prizren dhe numri i banorëve sipas kategorizimit të përgjegjësisë penale:				
Komunat		Numri banorëve resident	Nr. banorëve Penalisht të papërgjegjshëm (-14 vjeç)	Nr. banorëve Penalisht të përgjegjshëm (+14 vjeç)
1	Prizren	177,781	49,199	128,582
2	Suharekë	59,722	17,409	42,313
3	Dragash	33,997	8,658	25,339
4	Mamushë	5,507	1,826	3,681
Gjithsej		<b>277,007</b>	<b>77,092</b>	<b>199,915</b>



Hapësira territoriale e regjionit të Prizrenit

Figura 16

Theksojmë se **77,092** banorë të regjionit të Prizrenit i takojnë moshës nën 14 vjeçare dhe të njëjtin nuk janë të përgjegjshëm penalisht<sup>17</sup>.

<sup>17</sup> Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet. Neni 17.3 i Kodit Penal të Kosovës.

## 2.2 LLOJET E KRIMINALITETIT

Nga numri i përgjithshëm prej **199,915** banorëve të përgjegjshëm penalisht në regjionin e Prizrenit, përgjatë viteve (2013, 2014, 2015) **1,074** persona (banorë) janë proceduar në prokurori për tetë (8) grupe të veprave penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës<sup>18</sup>, që përbën **0.53%** të numrit të anorëve të përgjegjshëm penalisht në regjionin e Prizrenit. Konstatohet se çdo i **186** banorë i përgjegjshëm penalisht, ka qenë i përfshirë në njëren prej veprave penale karakteristike përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015).

Nga numrin e përgjithshëm **1,074** personave të përfshirë në kallëzimet penale, përgjatë tre viteve, sipas llojit të veprës penale, rezulton se: 38 persona kanë qenë të përfshirë në veprat penale të Armëve; 337 persona për Droga; 34 persona për Kontrabandim me migrant; 376 persona për Korrupsion; 6 persona për Shpërlarje të parasë; 21 persona për trafikim me qenie njerëzore; 220 për krime ekonomike dhe 2 persona për nxitje të urrejtjes (shih figurën 17).

VEPRA PENALE KARAKTERISTIKE	VITI	PERSONA TË PËRFSHIRË NË KALLËZIME PENALE	TOTALI PËR 3 VITE	Pjesëmarrja e veprës penale, me %
ARMËT	2013	19	38	3.53%
	2014	13		
	2015	6		
DROGAT	2013	111	377	35.10%
	2014	139		
	2015	127		
KONTRABANDA ME MIGRANT	2013	13	34	3.16%
	2014	5		
	2015	16		
KORRUPSIONI	2013	151	376	35%
	2014	124		
	2015	101		
SHPËRLARJA E PARASË	2013	4	6	0.55%
	2014	0		
	2015	2		
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	2013	7	21	1.95%
	2014	7		
	2015	7		
KRIMET EKONOMIKE	2013	0	220	20.48%
	2014	111		
	2015	109		
NXITJA URREJTJES	2013		2	0.18%
	2014			
	2015	2		
<b>Gjithsej:</b>				<b>100%</b>

Figura 17

<sup>18</sup> Prokuroria Themelore në Prizren përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) nuk ka proceduar me asnjë person për veprën penale të Krimit të organizuar.



## 2.3 PJESËMARRJA NË KRIMINALITET

Në vitin **2013**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Prizren **305** persona të përfshirë në kallëzimet penale për (6) grupeve të veprave penale karakteristike<sup>19</sup>, që përbën **0.15%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.11%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Prizrenit;

Në vitin **2014**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Prizren **399** persona të përfshirë në kallëzimet penale të gjashtë (6) grupeve të veprave penale karakteristike<sup>20</sup>, **0.19%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.14%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Prizrenit;

Në vitin **2015**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Prizren **370** persona të përfshirë në kallëzimet penale për tetë (8) grupet e veprave penale karakteristike<sup>21</sup>, e që përbën **0.13%** të numri të banorëve residentë të komunave në Regjionin e Prizrenit<sup>22</sup>.

Numri i përgjithshëm prej **1,074** personave të përfshirë të kallëzime penale përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015), përbën **0.38%** të numrit të banorëve resident apo **0.53%** të numrit të banorëve të moshës me përgjegjësi penale, të dyshuar për kryerjen e veprave penale. Ndërsa pjesëmarrja e personave sipas kategorizimit të veprës penale pasqyrohet në hartën (e dizajnuar *enkas*) territoriale të Kompetencës së Prokurorisë Themelore në Prizren (shih figurën 18).




Figura 18

<sup>19</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabanda me migrantë, (4) Korrupsioni, (5) Shpërlarja e parasë dhe (6) Trafikimi me qenie njerëzore.

<sup>20</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabanda me migrantë, (4) Korrupsioni, (5) Trafikimi me qenie njerëze dhe (6) Krimet ekonomike.

<sup>21</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabanda me migrantë, (4) Korrupsioni, (5) Shpërlarja e parasë, (6) Trafikimi me qenie njerëzore, (7) Krimet ekonomike dhe (8) Nxitja e urrejtjes.

<sup>22</sup> Prizren, Suharekë, Dragash dhe Mamushë.

## 2.4 ANALIZË KRAHASIMORE: NUMRI PERSONAVE TË DYSHUAR- NË RAPORT ME NUMRIN E BANORËVE

Të dhënat sasiore lidhur me numrin e personave të përfshirë në kallëzimet penale sipas llojit të veprës penale karakteristike përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) - në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht në regjionin e Prizrenit pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 19).

Pjesëmarrja e një personi në kallëzim penal në raport me numrin e banorëve penalisht të përgjegjshëm						
Veprat penale karakteristike	2013		2014		2015	
	Person a në vepër penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Persona në vepër penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Person a në vepër penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal
Armët	19	10,521	13	15,378	6	33,319
Drogat	111	1,801	139	1,438	127	1,574
Kontrab.me migrant	13	15,378	5	39,983	16	12,494
Krimi organizuar						
Korrupsioni	151	1,323	124	1,612	101	1,979
Shpërlarja e parasë	4	49,978			2	99,957
Trafikimi me njerëz	7	28,552	7	28,552	7	28,552
Krimet ekonomike			111	1,801	109	1,834
Nxitja urrejtjes					2	99,957
<b>Gjithsej:</b>	<b>305</b>	<b>655</b>	<b>399</b>	<b>501</b>	<b>370</b>	<b>540</b>

Figura 19

Përqindja e pjesëmarrjes së personave në veprat penale karakteristike, ne regjionin e Prizrenit, gjatë viteve 2013, 2014, 2015 pasqyrohet përmes grafikoneve ne vazhdim (shih figurën 20):




Figura 20

## 2.5 KONSTATIME

1. Në vitin 2013, një (1) person në **655** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Prizrenit, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
2. Në vitin 2014 një (1) person në **501** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Prizrenit, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
3. Në vitin 2015 një (1) person në **540** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Prizrenit, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
4. Pjesëmarrjen sasiore më të LARTË të personave të përfshirë në veprat penale gjatë tre viteve rezultojnë:
  - i. Në 2013, **Korrupsioni**, një (1) person në **1,323** banorë penalisht të përgjegjshëm;
  - ii. Në 2014, **Drogat**, një (1) person në **1,438** banorë penalisht të përgjegjshëm;
  - iii. Në 2015, **Drogat**, një (1) person në **1,574** banorë penalisht të përgjegjshëm;
5. Pjesëmarrjen sasiore më të ULËT të personave të përfshirë në veprat penale, gjatë tre viteve rezultojnë të kenë:
  - i. Në 2013, **Shpërlarja e parasë**, me një (1) person në **49,978** banorë, penalisht të përgjegjshëm;
  - ii. Në 2014, **Kontrabandimi me migrant**, 1 person në **39,983** banorë, penalisht të përgjegjshëm;
  - iii. Në 2015, **Shpërlarja e parasë dhe Nxitja urrejtjes**, me nga një (1) person në **99,957** banorë, penalisht të përgjegjshëm;

## 2.6 REKOMANDIME:

1. Ngritja e efikasitetit në luftimin e veprave penale të (1) Drogave, (2) Korrupsionit dhe të (3) Krimeve ekonomike, meqenëse këto vepra penale përbëjnë numrin më të madh të personave të përfshirë në kallëzime penale - në raport me tërësinë e veprave penale karakteristike në regjionin e Prizrenit. Respektivisht; vepra penale e Drogave përbën **35.10%**; ndërsa Korrupsioni **35%** të tërësisë së personave të përfshirë në veprat penale karakteristike për tre (3) vite. Ndërsa, veprat penale të Krimeve ekonomike vetëm për dy (2) vite (2014 dhe 2015) përbën **20.48%** të tërësisë së personave të përfshirë në veprat penale karakteristike për tre vitet e përlogaritjes sasiore.
2. Profilizimi i prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Prizren, për veprat penale të Drogave, Korrupsionit dhe Krimeve ekonomike, të cilat bartin ndjeshmërinë më të lartë publike, për sistemin prokurorial.
3. Angazhim i shtuar në trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

### 3. PEJA

#### 3.1 DEMOGRAFIA

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, rezultojnë se territori i Pejës, që përfshinë pesë (5) komuna: (1) Pejë; (2) Deçan; (3) Klinë; (4) Istog dhe (5) Junik, numëron 220.338 banorë resident, prej të cilëve **160,986** rezultojnë të jenë mbi moshën 14 vjeçare, dhe si të tillë janë të përgjegjshëm penalisht. Të dhënat sasiore të pesë (5) komunave, të klasifikuara sipas numrit të banorëve resident dhe të përgjegjshëm penalisht, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 21).

Theksojmë se Prokuroria Themelore në Pejë ka kompetencë territoriale në pesë komuna që përbëjnë regjionin e Pejës me numrin e përgjithshëm prej **160,986** banorëve, të përgjegjshëm penalisht.

REGJIONI I PEJËS				
Hapësira territoriale e kompetencës së Prokurorisë Themelore në Pejë dhe numri i banorëve sipas kategorizimit të përgjegjësisë penale:				
Komunat	Numri banorëve resident	Nr.banorëve Penalisht të papërgjegjshëm (-14 vjeç)	Nr.banorëve Penalisht të përgjegjshëm (+14 vjeç)	
1	Pejë	96,450	24,993	71,457
2	Deçan	40,019	10,471	29,548
3	Klinë	38,496	11,398	27,098
4	Istog	39,289	10,809	28,480
5	Junik	6,084	1,681	4,403
	Totali:	220.338	59,352	160,986



Hapësira territoriale e regjionit të Pejës

Figura 21

Theksojmë se **59,352** banorë në regjionin e Pejës i takojnë moshës nën 14 vjeçare dhe të njëjtin nuk janë të përgjegjshëm penalisht<sup>23</sup>.

<sup>23</sup> Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet. Neni 17.3 i Kodit Penal të Kosovës.

### 3.2 LLOJET E KRIMINALITETIT

Nga numri i përgjithshëm prej 160,986 banorëve të përgjegjshëm penalisht në regjionin e Pejës, përgjatë viteve (2013, 2014, 2015) **584** persona (banorë) janë proceduar në prokurori për shtatë (7) grupe të veprave penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës<sup>24</sup>, që përbën **0.36%** të numrit të banorëve të përgjegjshëm penalisht, në regjionin e Pejës. Konstatohet se çdo i **275** banorë i përgjegjshëm penalisht, ka qenë i përfshirë në njëren prej veprave penale karakteristike përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015).

Nga numrin e përgjithshëm prej **584** personave të përfshirë në kallëzimet penale, përgjatë tre viteve, sipas llojit të veprës penale, rezulton se: 3 persona kanë qenë të përfshirë në veprat penale të Armëve; 198 persona për Droga; 9 persona për Kontrabandim me migrant; 286 persona për Korrupsion; 17 persona për trafikim me qenie njerëzore; 67 persona për krime ekonomike dhe 4 persona për nxitje të urrejtjes (shih figurën 22).

VEPRA PENALE KARAKTERISTIKE	VITI	PERSONA TË PËRFSHIRË NË KALLËZIME PENALE	TOTAL PËR 3 VITE	PJESËMARRJA ME PËRQINDJE
ARMËT	2013	1	3	0.51%
	2014			
	2015	2		
DROGAT	2013	58	198	33.90%
	2014	80		
	2015	60		
KONTRABANDA ME MIGRANT	2013		9	1.54%
	2014	5		
	2015	4		
KORRUPSIONI	2013	129	286	48.97%
	2014	86		
	2015	71		
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	2013	3	17	2.91%
	2014	11		
	2015	3		
KRIMET EKONOMIKE	2013		67	11.47%
	2014	33		
	2015	34		
NXITJA URREJTJES	2013		4	0.68%
	2014			
	2015	4		
<b>Gjithsej</b>		<b>584</b>	<b>584</b>	<b>100%</b>

Figura 22

<sup>24</sup> Prokuroria Themelore në Prizren përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) nuk ka proceduar me asnjë person për veprat penale të Krimit të organizuar dhe Shpërlarjes së parasë.

### 3.3 PJESËMARRJA NË KRIMINALITET

Në vitin **2013**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Pejë **191** persona të përfshirë në kallëzimet penale për katër (4) grupeve të veprave penale karakteristike<sup>25</sup>, që përbën **0.11%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.08%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Pejë;

Në vitin **2014**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Pejë **215** persona të përfshirë në kallëzimet penale të pesë (5) grupeve të veprave penale karakteristike<sup>26</sup>, që përbën **0.13%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.09%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Pejë;

Në vitin **2015**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Pejë **178** persona të përfshirë në kallëzimet penale për shtatë (7) grupet e veprave penale karakteristike<sup>27</sup>, që përbën **0.11%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.08%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Pejë.

Numri i përgjithshëm prej **584** personave të përfshirë të kallëzimeve penale përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015), përbën **0.26%** të numrit të banorëve resident apo **0.36%** të numrit të banorëve të moshës me përgjegjësi penale, të dyshuar për kryerjen e veprave penale. Ndërsa pjesëmarrja e personave sipas kategorizimit të veprës penale pasqyrohet në hartën (të dizajnuar *enkas*) territoriale të Kompetencës së Prokurorisë Themelore në Pejë (shih figurën 23).




Figura 23

<sup>25</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Korrupsioni dhe (4) Trafikimi me qenie njerëzore.

<sup>26</sup> (1) Drogat (2) Kontrabanda me migrantë (3) Korrupsioni, (4) Trafikimi me qenie njerëze dhe (5) Krimet ekonomike.

<sup>27</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabanda me migrantë, (4) Korrupsioni, (5) Trafikimi me qenie njerëzore, (6) Krimet ekonomike dhe (7) Nxitja e urrejtjes.

### 3.4 ANALIZË KRAHASIMORE: NUMRI PERSONAVE TË DYSHUAR- NË RAPORT ME NUMRIN E BANORËVE

Të dhënat sasiore lidhur me numrin e personave të përfshirë në kallëzimet penale sipas llojit të veprës penale karakteristike përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) - në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht në regjionin e Pejës pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 24).

Pjesëmarrja e një personi në kallëzim penal në raport me numrin e banorëve penalisht të përgjegjshëm						
Veprat penale karakteristike	2013		2014		2015	
	Persona në vepër penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Persona në vepër penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Persona në vepër penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal
Armët	1	160,986			2	80,493
Drogat	58	2,775	80	2,012	60	2,683
Kontrab.me migrant			5	32,197	4	40,246
Krimi organizuar						
Korrupsioni	129	1,247	86	1,871	71	2,267
Shpërlarja e parasë						
Trafikimi me njerëz	3	53,662	11	14,635	3	53,662
Krimet ekonomike			33	4,878	34	4,734
Nxitja urrejtjes					4	40,246
<b>Gjithsej:</b>	<b>191</b>	<b>842</b>	<b>215</b>	<b>748</b>	<b>178</b>	<b>904</b>

Figura 24

Përqindja e pjesëmarrjes së personave në veprat penale karakteristike, në regjionin e Pejës, gjatë viteve 2013, 2014, 2015 pasqyrohet përmes grafikoneve në vazhdim (shih figurën 25):




Figura 25

### 3.5 KONSTATIME

1. Në vitin 2013, një (1) person në çdo **842** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Pejës, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
2. Në vitin 2014 një (1) person në çdo **748** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Pejës, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
3. Në vitin 2015 një (1) person në çdo **904** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Pejës, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
4. Pjesëmarrjen sasiore më të LARTË të personave të përfshirë në veprat penale gjatë tre viteve rezultojnë të ketë **Korrupsioni**, respektivisht:
  - i. Në 2013, një (1) person në **1,247** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - ii. Në 2014, një (1) person në **1,871** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - iii. Në 2015, një (1) person në **2,267** banorë, të përgjegjshëm penalisht.
5. Pjesëmarrjen sasiore më të ULËT, të personave të përfshirë në veprat penale, rezultojnë të kenë:
  - i. Në 2013, **Armët**, me një (1) person në **160,986** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - ii. Në 2014, **Kontrabandimi me migrant**, një (1) person në **32,197** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - iii. Në 2015, **Armët**, një (1) person në **80,493** banorë, të përgjegjshëm penalisht.

### 3.6 REKOMANDIME:

1. Ngritja e efikasitetit në luftimin e veprave penale të (1) Korrupsionit dhe (2) Drogave, meqenëse këto vepra penale përbëjnë numrin më të madh të personave të përfshirë në kallëzime penale - në raport me tërësinë e veprave penale karakteristike në regjionin e Pejës. Respektivisht; vepra penale e Korrupsionit përbën **48.97%** ndërsa Drogat **33.90%** të tërësisë së personave të përfshirë në veprat penale karakteristike për tre vitet;
2. Profilizimi i prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Pejës, për veprat penale të Korrupsionit dhe Drogave, të cilat bartin ndjeshmërinë më të lartë publike dhe përqindjen më të lartë të ngarkesës me lëndë, në këtë prokurori.
3. Angazhim i shtuar në trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.



## 4. GJILANI

### 4.1 DEMOGRAFIA

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, rezulton se territori i Gjilanit, që përfshinë shtatë komuna: (1) Gjilan; (2) Kamenicë; (3) Ranillug; (4) Novobërdë (5) Viti; (6) Klllokot dhe (7) Partesh, numëron **188,188** banorë resident, prej të cilëve **138,348** banorë rezulton të jenë mbi moshën 14 vjeçare, dhe si të tillë janë të përgjegjshëm penalisht. Të dhënat sasiore të shtatë (7) komunave, të klasifikuara sipas numrit të banorëve resident dhe të përgjegjshëm penalisht, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 26).

Theksojmë se Prokuroria Themelore në Gjilan, ka kompetencë territoriale në pesë komuna që përbëjnë regionin e Pejës me numrin e përgjithshëm prej **138,348** banorëve, të përgjegjshëm penalisht.

REGJIONI I GJILANIT				
Hapësira territoriale e kompetencës së Prokurorisë Themelore në Gjilanit dhe numri i banorëve sipas kategorizimit të përgjegjësisë penale:				
Komunat	Numri banorëv e resident	Nr.banorëv e Penalisht të papërgjegjshëm (-14 vjeç)	Nr.banorëve Penalisht të përgjegjshëm (+14 vjeç)	
1	Gjilan	90,178	23,464	66,714
2	Kamenicë	36,085	8,900	27,185
3	Ranillug	3,866	655	3,211
4	Novodërd	6,729	1,643	5,086
5	Viti	46,987	14,168	32,819
6	Klllokot	2,556	670	1,886
7	Partesh	1,787	340	1,447
	Totali	188.188	49,840	138,348



Hapësira territoriale e regjionit të Gjilanit

Figura 26

Theksojmë se **49,840** banorë në regjionin e Gjilanit, i takojnë moshës nën 14 vjeçare dhe të njëjtin nuk janë të përgjegjshëm penalisht<sup>28</sup>.

<sup>28</sup> Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet. Neni 17.3 i Kodit Penal të Kosovës.

## 4.2 LLOJET E KRIMINALITETIT

Nga numri i përgjithshëm prej 138,348 banorëve të përgjegjshëm penalisht në regionin e Gjilanit, përgjatë viteve (2013, 2014, 2015) **628** persona (banorë) janë proceduar në prokurori për gjashtë (6) grupe të veprave penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës<sup>29</sup>, që përbën **0.45%** të numrit të banorëve të përgjegjshëm penalisht, në regionin e Gjilanit. Konstatohet se çdo i **220** banorë, i përgjegjshëm penalisht, ka qenë i përfshirë në njëren prej veprave penale karakteristike<sup>30</sup> përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015).

Nga numrin e përgjithshëm prej **628** personave të përfshirë në kallëzimet penale, përgjatë tre viteve, sipas llojit të veprës penale, rezulton se: 19 persona kanë qenë të përfshirë në veprat penale të Armëve; 176 persona për Droga; 61 persona për Kontrabandim me migrant; 253 persona për Korrupsion; 15 persona për trafikim me qenie njerëzore; dhe 104 persona për krime ekonomike (shih figurën 27).

VEPRA PENALE KARAKTERISTIKE	VITI	PERSONA TË PËRFSHIRË NË KALLËZIME PENALE	TOTAL PËR 3 VITE	Pjesëmarrja me përqindje
ARMËT	2013	13	<b>19</b>	<b>3.02%</b>
	2014	6		
	2015			
DROGAT	2013	60	<b>176</b>	<b>28.02%</b>
	2014	75		
	2015	41		
KONTRABANDA ME MIGRANT	2013	24	<b>61</b>	<b>9.71%</b>
	2014	24		
	2015	13		
KORRUPSIONI	2013	112	<b>253</b>	<b>40.28%</b>
	2014	75		
	2015	66		
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	2013	6	<b>15</b>	<b>2.38</b>
	2014	5		
	2015	4		
KRIMET EKONOMIKE	2013		<b>104</b>	<b>16.56%</b>
	2014	72		
	2015	32		
<b>Gjithsej</b>		<b>628</b>	<b>628</b>	<b>100%</b>

Figura 27

<sup>29</sup> Prokuroria Themelore në Gjilan përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) nuk ka proceduar me asnjë person për veprat penale të Krimit të organizuar, Shpërlarjes së parasë dhe Nxitjes së urrejtjes.

<sup>30</sup> (1) Armët, (2) Droga, (3) Kontrabanda me migrantë, (4) Korrupsioni, (5) Trafikimi me qenie njerëzore, (6) Krime ekonomike.

### 4.3 PJESËMARRJA NË KRIMINALITET

Në vitin **2013**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Gjilan **215** persona të përfshirë në kallëzimet penale për pesë (5) grupeve të veprave penale karakteristike<sup>31</sup>, e që përbën **0.15%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.11%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Gjilanit.

Në vitin **2014**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Gjilan **257** persona të përfshirë në kallëzimet penale të gjashtë (6) grupeve të veprave penale karakteristike<sup>32</sup>, që përbën **0.18%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.13%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Gjilan;

Në vitin **2015**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Gjilan **156** persona të përfshirë në kallëzimet penale për pesë (5) grupet e veprave penale karakteristike<sup>33</sup>, që përbën **0.11%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.08%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Gjilanit.

Numri i përgjithshëm prej **628** personave të përfshirë të kallëzime penale përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015), përbën **0.33%** të numrit të banorëve resident apo **0.45%** të numrit të banorëve të moshës me përgjegjësi penale, të dyshuar për kryerjen e veprave penale<sup>34</sup>. Ndërsa pjesëmarrja e personave sipas kategorizimit të veprës penale pasqyrohet në hartën (të dizajnuar *enkas*) territoriale të Kompetencës së Prokurorisë Themelore në Gjilan (shih figurën 28).




Figura 28

<sup>31</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabanda me migrantë, (4) Korrupsioni dhe (5) Trafikimi me njerëz.

<sup>32</sup> (1) Armët, (2) Drogat, (3) Kontrabanda me migrantë, (4) Korrupsioni (5) Trafikimi me njerëz dhe (6) Krimet ekonomike.

<sup>33</sup> (1) Drogat, (2) Kontrabanda me migrantë, (3) Korrupsioni, (4) Trafikimi me qenie njerëzore, dhe (5) Krimet ekonomike.

<sup>34</sup> Prokuroria Themelore në Gjilan përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) nuk ka proceduar me asnjë person për veprat penale të Krimit të organizuar, Shpërlarjes së parasë dhe Nxitjes së urrejtjes.

#### 4.4 ANALIZË KRAHASIMORE: NUMRI PERSONAVE TË DYSHUAR- NË RAPORT ME NUMRIN E BANORËVE

Të dhënat sasiore lidhur me numrin e personave të përfshirë në kallëzimet penale sipas llojit të veprës penale karakteristike përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) - në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht në regionin e Gjilan, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 29).

Pjesëmarrja e një personi në kallëzim penal në raport me numrin e banorëve penalisht të përgjegjshëm						
Veprat penale karakteristike	2013		2014		2015	
	Personat në veprat penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Personat në veprat penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Personat në veprat penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal
Armët	13	10,634	6	23,058		
Drogat	60	2,305	75	1,844	41	3,374
Kontrab. migrant	24	5,764	24	5,764	13	10,642
Krimi organizuar						
Korrupsioni	112	1,235	75	1,844	66	2,096
Shpërlarja e parasë						
Trafikimi me njerëz	6	23,058	5	27,669	4	34,587
Krimet ekonomike			72	1,921	32	4,323
Nxitja urrejtjes						
<b>Gjithsej:</b>	<b>215</b>	<b>643</b>	<b>257</b>	<b>538</b>	<b>156</b>	<b>886</b>

Figura 29

Përqindja e pjesëmarrjes së personave në veprat penale karakteristike, në regionin e Gjilanit, gjatë viteve 2013, 2014, 2015 pasqyrohet përmes grafikoneve në vazhdim (shih figurën 30):




Figura 30

#### 4.5 KONSTATIME

1. Në vitin 2013, një (1) person në çdo **643** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Gjilanit, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
2. Në vitin 2014 një (1) person në çdo **538** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Gjilanit, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
3. Në vitin 2015 një (1) person në çdo **886** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Gjilanit, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
4. Pjesëmarrjen sasiore më të LARTË të personave të përfshirë në veprat penale gjatë tre viteve rezulton të kenë:
  - i. Në 2013, **Korrupsioni**: një (1) person në **1,235** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - ii. Në 2014, **Korrupsioni, Drogat**: një (1) person në **1,844** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - iii. Në 2015, **Korrupsioni**: një (1) person në **2,096** banorë, të përgjegjshëm penalisht.
5. Pjesëmarrjen sasiore më të ULËT, të personave të përfshirë në veprat penale gjatë tre viteve rezulton të ketë **Trafikimi me qenie njerëzore**, respektivisht:
  - i. Në 2013, një (1) person në **23,058** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - ii. Në 2014, një (1) person në **27,669** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - iii. Në 2015, një (1) person në **34,587** banorë, të përgjegjshëm penalisht.

#### 4.6 REKOMANDIME:

1. Ngritja e efikasitetit në luftimin e veprave penale të (1) Korrupsionit, (2) Drogave dhe (3) Krimeve ekonomike, meqenëse përbëjnë numrin më të madh të personave të përfshirë në kallëzime penale për këto vepra penale - në raport me tërësinë e veprave penale karakteristike në regjionin e Gjilanit. Respektivisht; vepra penale e Korrupsionit përbën **40%**; Drogat **28%**, dhe Krimet ekonomike **17%** të tërësisë së personave të përfshirë në veprat penale karakteristike për tre vitet;
2. Profilizimi i prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Gjilan, për veprat penale të Korrupsionit, Drogave dhe Krimeve ekonomike, të cilat bartin ndjeshmërinë më të lartë publike dhe përqindjen më të lartë të ngarkesës me lëndë, në këtë prokurori.
3. Angazhim i shtuar në trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.


## 5. MITROVICA

### 5.1 DEMOGRAFIA

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës vetëm në tre (3) nga shtatë (7) komunat që përfshinë territori i Mitrovicës: (1) Mitrovica; (2) Skenderaj; dhe (3) Vushtrri; banojnë **192.637** banorë resident, prej të cilëve **137,621** banorë rezultojnë të jenë mbi moshën 14 vjeçare, dhe si të tillë janë të përgjegjshëm penalisht<sup>35</sup>. Të dhënat sasiore të tre (3) komunave, të klasifikuara sipas numrit të banorëve resident dhe të përgjegjshëm penalisht, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 31).

Theksojmë se Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka kompetencë territoriale në shtatë (7) komuna të regionit të Mitrovicës, dhe se numri i banorëve të regjistruar vetëm në tre komunat respective përfshinë **137,621** të përgjegjshëm penalisht.

REGJIONI I MITROVICËS			
Hapësira territoriale e kompetencës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe numri i banorëve sipas kategorizimit të përgjegjësisë penale:			
Komunat	Numri banorëv e resident	Nr.banorëve Penalisht të papërgjegjshëm (-14 vjeç)	Nr.banorëve Penalisht të përgjegjshëm (+14 vjeç)
1 Mitrovicë	71,909	20,351	51,558
2 Leposaviq			
3 Zubin Potok			
4 Zveqan			
5 Mitrovica V.			
6 Skenderaj	50,858	15,031	35,827
7 Vushtrri	69,870	19,634	50,236
Totali:	192.637	55,016	137,621



Hapësira territoriale e regjionit të Mitrovicës

Figura 31

Theksojmë se **55,016** banorë në regjionin e Mitrovicës, i takojnë moshës nën 14 vjeçare dhe të njëjtin nuk janë të përgjegjshëm penalisht<sup>36</sup>.

<sup>35</sup> Në territorin e regjionit të Mitrovicës bëjnë pjesë edhe komunat: (1) Leposaviq, (2) Zubin potok; (3) Zveqan dhe (4) Mitrovica e veriut, në të cilat nuk është realizuar regjistrimi i popullsisë në vitin 2011.

<sup>36</sup> Personi nuk është penalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën katërmëdhjetë (14) vjet. Neni 17.3 i Kodit Penal të Kosovës.

## 5.2 LLOJET E KRIMINALITETIT

Nga numri i përgjithshëm prej **137,621** banorëve të përgjegjshëm penalisht në regjionin e Mitrovicës, përgjatë viteve (2013, 2014, 2015) **830** persona (banorë) janë proceduar në prokurori për gjashtë (6) grupe të veprave penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës<sup>37</sup>, që përbën **0.60%** të numrit të banorëve të përgjegjshëm penalisht të regjionit të Mitrovicë.

Konstatohet se çdo i **165** banorë i përgjegjshëm penalisht, ka qenë i përfshirë në njëren prej veprave penale karakteristike<sup>38</sup> përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015).

Nga numrin e përgjithshëm prej **830** personave të përfshirë në kallëzimet penale, përgjatë tre viteve, sipas llojit të veprës penale, rezulton se: **238** persona për Droga; **19** persona për Kontrabandim me migrant; **221** persona për Korrupsion; **33** persona për Trafikim me qenie njerëzore; **316** persona për Krime ekonomike dhe **3** për Nxitje të urrejtjes (shih figurën 32).

VEPRA PENALE KARAKTERISTIKE	VITI	PERSONA TË PËRFSHIRË NË KALLËZIME PENALE	TOTAL PËR 3 VITE	PJESËMARRJA ME PËRQINDJE
DROGAT	2013	55	<b>238</b>	<b>28.67 %</b>
	2014	53		
	2015	130		
KONTRABANDIMI ME MIGRANT	2013		<b>19</b>	<b>2.28 %</b>
	2014	7		
	2015	12		
KORRUPSIONI	2013	59	<b>221</b>	<b>26.62 %</b>
	2014	69		
	2015	93		
TRAFIKIMI ME QENIE NJERËZORE	2013	9	<b>33</b>	<b>3.97 %</b>
	2014	16		
	2015	8		
KRIMET EKONOMIKE	2013		<b>316</b>	<b>38.07 %</b>
	2014	114		
	2015	202		
NXITJA URREJTJES	2013		<b>3</b>	<b>0.36 %</b>
	2014			
	2015	3		
<b>Gjithsej</b>		<b>830</b>	<b>830</b>	<b>100%</b>

Figura 32

<sup>37</sup> (1) Droga, (2) Kontrabanda me migrantë, (3) Korrupsioni, (4) Trafikimi me qenie njerëzore, (5) Krime ekonomike dhe (6) Nxitja urrejtjes.

<sup>38</sup> Prokuroria Themelore në Mitrovicë përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) nuk ka proceduar me asnjë person për veprat penale të Armëve, Krimit të organizuar dhe të Shpërlarjes së parasë.

### 5.3 PJESËMARRJA NË KRIMINALITET

Në vitin **2013**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë **123** persona të përfshirë në kallëzimet penale për tre (3) grupe të veprave penale karakteristike<sup>39</sup>, e që përbën **0.08%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.06%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Mitrovicës;

Në vitin **2014**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë **259** persona të përfshirë në kallëzimet penale të pesë (5) grupeve të veprave penale karakteristike<sup>40</sup>, që përbën **0.18%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.13%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Mitrovicës;

Në vitin **2015**, subjektet parashtruese të kallëzimeve penale, kanë proceduar në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë **448** persona të përfshirë në kallëzimet penale për gjashtë (6) grupet e veprave penale karakteristike<sup>41</sup>, që përbën **0.32%** të numrit të banorëve penalisht të përgjegjshëm, apo **0.23%** të numrit të banorëve resident në regjionin e Mitrovicës.

Numri i përgjithshëm prej **830** personave të përfshirë të kallëzime penale përgjatë tre viteve (2013, 2014 dhe 2015), përbën **0.43%** të numrit të banorëve resident apo **0.60%** të numrit të banorëve të moshës me përgjegjësi penale, të dyshuar për kryerjen e veprave penale<sup>42</sup>. Ndërsa pjesëmarrja e personave sipas kategorizimit të veprës penale pasqyrohet në hartën (e dizajnuar enkas) territoriale të Kompetencës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë (shih figurën 33).




Figura 33

<sup>39</sup> (1) Drogat, (2) (Korrupsioni dhe (3) Trafikimi me njerëz.

<sup>40</sup> (1) Drogat, (2) Kontrabanda me migrantë, (3) Korrupsioni (4) Trafikimi me njerëz dhe (5) Krimet ekonomike.

<sup>41</sup> (1) Drogat, (2) Kontrabanda me migrantë, (3) Korrupsioni, (4) Trafikimi me qenie njerëzore, (5) Krimet ekonomike dhe (6) Nxitja urrejtjes.

<sup>42</sup> Prokuroria Themelore në Mitrovicë përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) ka proceduar 830 persona për veprat penale (1) Drogat, (2) Kontrabanda me migrantë, (3) Korrupsioni, (4) Trafikimi me qenie njerëzore, (5) Krimet ekonomike dhe (6) Nxitja urrejtjes.



#### 5.4 ANALIZË KRAHASIMORE: NUMRI PERSONAVE TË DYSHUAR- NË RAPORT ME NUMRIN E BANORËVE

Të dhënat sasiore lidhur me numrin e personave të përfshirë në kallëzimet penale sipas llojit të veprës penale karakteristike përgjatë tre viteve (2013, 2014, 2015) - në raport me numrin e banorëve të përgjegjshëm penalisht në regjionin e Mitrovicë, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 34).

Pjesëmarrja e një personi në kallëzim penal në raport me numrin e banorëve penalisht të përgjegjshëm						
Veprat penale karakteristike	2013		2014		2015	
	Persona në vepër penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Persona në vepër penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal	Persona në vepër penale	Mesatarja e banorëve penalisht përgjegjshëm për një person në kallëzim penal
Armët						
Drogat	55	2,502	53	2,596	130	1,058
Kontrab.me migrant			7	19,660	12	11,468
Krimi organizuar						
Korrupsioni	59	2,332	69	1,994	93	1,479
Shpërlarja e parasë						
Trafikimi me njerëz	9	15,291	16	8,601	8	17,202
Krimet ekonomike			114	1,207	202	681
Nxitja urrejtjes					3	45,873
<b>Gjithsej:</b>	<b>123</b>	<b>1,118</b>	<b>259</b>	<b>531</b>	<b>448</b>	<b>307</b>

Figura 34

Përqindja e pjesëmarrjes së personave në veprat penale karakteristike, në regjionin e Mitrovicës, gjatë viteve 2013, 2014, 2015 pasqyrohet përmes grafikoneve në vazhdim (shih figurën 35):




Figura 35

## 5.5 KONSTATIME

1. Në vitin 2013, një (1) person në çdo **1,118** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Mitrovicës, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
2. Në vitin 2014 një (1) person në çdo **531** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Mitrovicës, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
3. Në vitin 2015 një (1) person në çdo **307** banorë penalisht të përgjegjshëm në regjionin e Mitrovicës, ka qenë i përfshirë në ndonjërin nga veprat penale karakteristike;
4. Pjesëmarrjen sasiore më të LARTË të personave të përfshirë në veprat penale gjatë tre viteve rezulton të kenë:
  - i. Në 2013, **Korrupsioni**: një (1) person në **2,332** banorë të përgjegjshëm penalisht;
  - ii. Në 2014, **Krimet ekonomike**: një (1) person në **1,207** banorë të përgjegjshëm penalisht;
  - iii. Në 2015, **Krimet ekonomike**: një (1) person në **681** banorë, të përgjegjshëm penalisht.
5. Pjesëmarrjen sasiore më të ULËT, të personave të përfshirë në veprat penale gjatë tre viteve rezulton të kenë:
  - i. Në 2013, **Trafikimi me qenie njerëzore**: një (1) person në **15,291** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - ii. Në 2014, **Kontrabandimi me migrant**: një (1) person në **19,660** banorë, të përgjegjshëm penalisht;
  - iii. Në 2015, **Nxitja urrejtjes**: një (1) person në **45,873** banorë, të përgjegjshëm penalisht.

## 5.6 REKOMANDIME:

1. Ngritja e efikasitetit në luftimin e veprave penale të (1) Krimeve ekonomike; (2) Drogave dhe (3) Korrupsionit, meqenëse përbëjnë numrin më të madh të personave të përfshirë në kallëzime penale për këto vepra penale - në raport me tërësinë e personave të përfshirë në veprat penale karakteristike në regjionin e Mitrovicës. Respektivisht; vepra penale e Krimeve ekonomike përbën **38%**; Drogat **29%**, dhe Korrupsionit **27%** të tërësisë sasiore të personave të përfshirë në veprat penale karakteristike për tre vitet;
2. Profilizimi i prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, për veprat penale të Krimeve ekonomike, Drogave dhe Korrupsionit, të cilat bartin ndjeshmërinë më të lartë publike dhe përqindjen më të lartë të ngarkesës me lëndë, në këtë prokurori.
3. Angazhim i shtuar në trajtimin e lëndëve që kanë të bëjnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, veçanërisht në kuadër të grupeve të veprave penale të Krimeve ekonomike dhe të Korrupsionit.

## 6. FERIZAJ

### 6.1 DEMOGRAFIA

Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, të realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në pesë komunat që përfshinë territori i Ferizajit: (1) Ferizaj; (2) Kaçanik; (3) Shtime; (4) Shtërpce dhe (5) Hani Elezit banojnë 185.695 banorë resident, prej të cilëve 131,418 banorë rezulton të jenë mbi moshën 14 vjeçare, dhe si të tillë janë të përgjegjshëm penalisht.

Të dhënat sasiore të pesë (5) komunave, të klasifikuara sipas numrit të banorëve resident dhe të përgjegjshëm penalisht, pasqyrohen në tabelën në vazhdim (shih figurën 36).

Theksojmë se Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka kompetencë territoriale në pesë (5) komuna të regionit të Ferizajit që përfshinë 137,621 banorë të përgjegjshëm penalisht.

REGJIONI I FERIZAJIT				
Hapësira territoriale e kompetencës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe numri i banorëve sipas kategorizimit të përgjegjësisë penale:				
Komunat	Numri banorëve resident	Nr.banorëv e Penalisht të papërgjegjshëm (-14 vjeç)	Nr.banorëve Penalisht të përgjegjshëm (+14 vjeç)	
1	Ferizaj	108,610	31,566	77,044
2	Kaçanik	33,409	9,581	23,828
3	Shtime	27,324	8,581	18,743
4	Shtërpce	6,949	1,771	5,178
5	Hani i Elezit	9,403	2,778	6,625
	Totali:	185.695	54,277	131,418



